



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:121682

Datë: 14.02.2025

Numri i dokumentit: 06850273

**C.nr.590/24**

**Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Petrit Curri, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësve S.M.dhe M.M.të punësuar në SHFMU “M.” në fshatin L., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Zahir Hamza nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim të borxhit në emër të licencimit/kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 14.02.2025 muar këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.M.dhe M.M.të punësuar në SHFMU “M.” në fshatin L., Komuna e Malishevës.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit që në emër të kompensimit të kualifikimit/licencimit, t’ua paguaj paditësve si në vijim:

- Paditësit **S.M.dhe** atë në emër të kualifikimit-licencimit kompensimit të pagës mbi pagën bazë (paga bazë 421,00 € \* 27% i pagës bazë (113.67 € - 58.32 diferencë e paguar në page = 55.35 €) për periudhën e vitit 2021 dhe 2022 x 24 muaj gjithsej 24\* 55.35 = **1,328.00 euro**;
- Paditësit **M.M.dhe** atë në emër të kualifikimit-licencimit kompensimit të pagës mbi pagën bazë (paga bazë 421,00 € \* 27% i pagës bazë (113.67 € - 58.32 diferencë e paguar në page = 55.35 €) për periudhën e vitit 2021 dhe 2022 x 24 muaj gjithsej 24\* 55.35 = **1,328.00 euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e parashtrimit të padisë dt. 01.03.2024, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**III. DETYROHET** e paditura që paditësve t’ua kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 208.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 31.00 euro.

**A r s y e t i m**

Paditësit S.M.dhe M.M.të punësuar në SHFMU “M.” në fshatin L., Komuna e Malishevës përmes të autorizuarit të tyre Av. Zahir Hamza nga Prishtina në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim të borxhit në emër të licencimit/kualifikimit, sipas padisë paditësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHFMU “M.” në fshatin L., Komuna e Malishevës, paditësit e sipërshtetë plotësojnë kushtet e përfitimit mbi bazën e kualifikimit sipas kushteve të parapara me Vendimin e Qeverisë nr.01.33 të datës 29.08.2008, për çka pretendojmë se u takon kompensimi, gjykatës i ka propozuar të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësve, ashtu që për paditësin S.M.paga bazë (421.00 euro x27%) =113.67, zbritja e pjeshme 58.32 euro diferencë e cila është paguar, diferenca e pa paguar në shumën prej 55.35, për periudhën janar- dhjetor për vitin 2021 për 12 muaj x 55.35 = 664.00 euro, dhe për periudhën janar- dhjetor për vitin 2022 për 12 muaj x 55.35 = 664.00 euro, në shumën prej 1,328.00 euro, për paditësin M.M.paga bazë (421.00 euro x27%) =113.67, zbritja e pjeshme 58.32 euro diferencë e cila është paguar, diferenca e pa paguar në shumën prej 55.35, për periudhën janar- dhjetor për vitin 2021 për 12 muaj x 55.35 = 664.00 euro, dhe për periudhën janar- dhjetor për vitin 2022 për 12 muaj x 55.35 = 664.00 euro, në shumën prej 1,328.00 euro me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për parashtrimin e padisë t’ia paguaj shumën prej 208.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 31 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësve e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi ne ketë rast e lidhur më pagesën e kualifikimit nuk ka asnjë bazë ligjore ne kontratën kolektive, për faktin se baze te kontratës së mësimdhënësve kualifikimi i paguhet çdo mësimdhënësi që është paraqitur ne kontratën e punës gradimi mbi pagën baze. Kontratën Kolektive te Arsimit ne Kosovë të datës 18.04.2021, ne veçanti nenin 7 [Licencimi] ku paditësit pretendon se i takon e drejta e kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, kjo dispozitë përcakton se me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karriere dhe zhvillim profesional ne baze te legjislacionit te punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit te arsimit ne fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënës me diplome fakulteti tri dhe katër vjeçare 27 % të pagës baze, padia është në tërësi e pabazuar dispozitat e këtij neni nuk ka karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira ne procesin e licencimit, por kjo dispozitës se lartcekur shihet qarte që qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar dhe assesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV te kësaj kontrate [RREGULLAT E PERGJITHSHME DHE PAGAT], ku në nenin 35 janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu nga pika 4 deri në piken 10 janë përcaktuar këto obligime financiare te të paditurës: kompensimi për orët shtese, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në

shkallë te pranuar nga enti i Statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar me nenin 7 të kontratës , për çka pretendimet e paditësve për mungesë dhe mos planifikim të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor. Për më tepër, në paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se "Pagat e punëtorëve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit në Kosovë, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim.", andaj me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara, po ashtu edhe po që se në këtë rast do të kishte kjo padi bazë ligjore në bazë të kontratës kolektive të arsimit vitit 2021, kemi të bëjmë më parashkrim në bazë të nenit 352 dhe neni 353 pika 1 e LMD —së, kjo kërkesë padi është e pasafatshme, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë dega Malishevë, të Refuzoj si të pa bazuar padinë e paditësve sepse, nuk ekziston asnjë bazë ligjore lidhur me këtë rast që ekziston ky detyrim në bazë të kontratës kolektive te vitit 2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësin M.M., kontratën e punës nr.11/702 të datës 06.11.2017, diplomën nr.66 të datës 26.01.2013, Licencën e Punës nr.100023533, për paditësin S.M., kontratën e punës nr.11/701 të datës 06.11.2017, diplomën nr.65 të datës 25.02.2013, Licencën e Punës nr.100023534.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, dhe si të tillë të njëjtën e aprovojë në tërësi për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin e plotë në emër të licencimit/kualifikimit, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas nenit 7 paragrafi 1, pika 3 në të cilën përcaktohet se ***“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë”***.

Sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008 në pikën 4 përcaktohet se ***“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët***

*profesional të pajisur me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%, me diplomë, me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 % dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”* ndërsa nga Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të nxjerrë nga seanca e përgjithshme i datës 09.10.2023 GJ.A-SU 214/2023 i cili derivon nga vendimi i Qeverisë së Kosovës në pikën I përcaktohet se **“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensimin mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushtëve dhe kritereve të përcaktuara me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008,”** kjo gjykatë vlerëson se mbi bazën e Kontratës Kolektive- Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës paditësit i takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit për periudhën 2021- 2022 si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata u bazua në diplomatat e kualifikimit të paditësve, licencimin dhe kontratën e punës.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit të debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**.

Meqenëse nga parashtrësia e padisë u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se **“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundëjt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”**, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”**, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i kontestuar fare faktet vendimtarë dhe as të drejtat e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit, andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësve.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e paditurës, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin në emër të licencimit obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008 dhe Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, sa i përket pretendimeve të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësit padinë e kanë parashtruar në vitin 2024, ndërsa kërkespadija rezultoi e kërkuar për periudhën e vitit 2021-2022 e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashkrimit të padisë (01.03.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë shumën prej 208.00 euro në emër të parashkrimit të padisë dhe shumën prej 31.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

**Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**

**C.nr.590/24 me datën 14.02.2025**

**Gj y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.